

## CLR INFO PER WEB

Në kuadër të zbatimit të Planit të Advokacisë, CLR ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësimi, si online ashtu edhe në takime fizike, për të promovuar barazinë gjinore dhe zgjidhjen jodhunshme të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale, duke theksuar rëndësinë e këtyre çështjeve në edukim. Gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës (25 Nëntor - 10 Dhjetor), CLR iu bashkua përpjekjeve për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave duke lançuar fushatën "*Respekt në Çdo Fjalë*", me mesazhin kryesor: "*Respekti fillon me një fjalë, qëndron në çdo veprim.*" Aktivitetet përfshinë **katër sesione edukative** në universitetet kryesore të vendit dhe iniciativën "**Pema e Respektit**", një hapësirë virtuale ku për 16 ditë u shtua çdo ditë një mesazh mbi rëndësinë e respektit si bazë e çdo marrëdhënieje të shëndetshme.



## Pema e Respektit:



Në vijim të *Analizës Vlerësuese të Kurrikulave* të kryer nga Qendra për të Drejtat në Punë, CLR në bashkëpunim me organizatën partnere *ACPD Albania* gjithashtu pjesë e *Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore* u mbajt një takim për të marrë komentet dhe feedback nga vetë të rinjtë mbi rekomandimet e GREVIO për edukimin. Diskutimi u bazua në trinomin: gjinia, edukimi dhe punësimi, duke adresuar gjithashtu dhunën dixhitale ndaj grave dhe ndikimin e saj pa stigmatizuar viktimat. U prezantua analiza vlerësuese e kurrikulave dhe rekomandimet e GREVIO për edukimin, duke krijuar një hapësirë për shkëmbim mendimesh dhe propozime konkrete për përmirësimin e sistemit arsimor në drejtim të një qasjeje më të barabartë dhe të sigurt për të gjithë.



Advokimi u krye nga organizata CLR, organizatë anëtare e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në kuadrin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve GREVIO për Shqipërinë, në zbatim të projektit “Fuqizimi i Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore drejt realizimit progresiv të Agjendës normative të barazisë gjinore përmes përdorimit të standardeve ndërkombëtare të Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit”, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj Grave” i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.